

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6490
E enjte, 16 dhjetor 2021
çmimi 0.40 €

Paralajmërohet
gjendje e jashtëzakonshme
me rrymë | FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ËSHTË MBAJTUR KONFERENCA E TETË STATUSORE NDAJ ISH-KRERËVE TË UÇK-së

FAQE 4-5

MBROJTJA, ANKESA NDAJ ZPS-së SA I PËRKET NXJERRJES SË MATERIALEVE



Mbrojtja e ish-krerëve të UÇK-së ka drejtuar të mërkurën ankesa ndaj Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) sa i përket nxjerrjes së materialeve. Avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka thënë se deri më tani mbrojtja ka marrë 13 800 prova dhe më shumë se 11 000 prej tyre i ka marrë pas afatit për nxjerrje të materialeve të 23 korrikut të këtij viti. Ndërkaq avokati i ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçit, Gregory Kehoe, ka pasur mjaft kritika ndaj ZPS-së sa i përket mospranimit të garancisë së Policisë së Kosovës për lirimim me kusht të Thaçit dhe të tjerëve

AKTUALE



KRIZA ENERGETIKE, ABDIXHIKU: QEVERIA KURTI, E PAAFTË DHE TALLËSE F. 7

AKSION I POLICISË NË KARAÇEVË, KONFISKOHEN APARATE TË BIXHOZIT DHE RRËNOHEN OBJEKTET ILEGALE F. 7

11 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË F. 3

PEACH: DUAM BALLKAN TË SIGURT F. 3



Kushtetuesja shfuqizon vendimin për shkarkimin e pesë anëtarëve të KPMSHCK-së | FAQE 5



OSMANI DHE PENDAROVSKI DYSHOJNË NË SUKSESIN E 'BALLKANIT TË HAPUR'

FAQE 4-5

EKONOMI



NDRYSHIMET NË ÇMIM TË VAJIT, DERI NË 84 PËR QIND F. 8

SPORT



ZHEGROVA: HERËT A VONË DO TË LUAJ PËR BARCELONËN F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Peach: Duam Ballkan të sigurt

LONDËR, 15 DHJETOR - Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar do një Ballkan Perëndimor të sigurt, me institucione të forta, demokratike dhe me sundim të fortë të ligjit. Kështu ka thënë i dërguari i posaçëm britanik për Ballkanin Perëndimor, Stuart Peach. Në një videomesazh për qytetarët e Bosnjë dhe Hercegovinës, me rastin e vizitës së tij në këtë vend, Peach ka theksuar se kryeministri britanik, Boris Johnson, i ka kërkuar ta marrë pozitën, për t'i mbështetur përpjekjet e Britanisë në të gjithë rajonin. Ai ka theksuar se dëshiron të ofrojë mbështetje për zgjidhjet politike, si dhe t'i promovojë integritet euroatlantike. "Gjatë vizitës sime në Bosnje do të

takohem me politikanë të rangut të lartë, agjenci për zbatimin e ligjit, parlamentarë dhe, çfarë është e rëndësishme, me aktorë të rinj të shoqërisë civile, që punojnë për ta promovuar paqen dhe pajtimin. I gëzohem bashkëpunimit të ngushtë me të gjithë partnerët, përfshirë edhe përfaqësuesin e lartë [ndërkombëtar] dhe aleatët tanë ndërkombëtarë, si dhe ofrimin e mbështetjes për ata që angazhohen për përparimin e këtij vendi. Sot jam në Sarajevë në kuadër të vizitës sime të parë si i dërguar i posaçëm", ka thënë ai në videomesazhin e publikuar në llogarinë e tij në "Twitter". Peach u emërua në pozitën e të dërguarit të posaçëm të



Britanisë së Madhe për Ballkanin Perëndimor në fillim të dhjetorit.

Në deklaratën pas emërimit të tij, qeveria britanike tha se Peach do ta mbështesë punën e

përfaqësuesit të lartë ndërkombëtar në Bosnje, Christian Schmidt.

Sa i përket Kosovës dhe Serbisë, ai do të bashkëpunojë me partnerët e Britanisë, në mbështetjen e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve midis dy vendeve, të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.

Këtë vit edhe Shtetet e Bashkuara kanë emëruar të dërguar të ri të posaçëm për Ballkanin Perëndimor.


Gabriel Escobar e ka zëvendësuar Matthew Palmerin nga muaji shtator. Aktualisht Palmer është i dërguar i posaçëm i ShBA-së për reformën zgjedhore në Bosnjë e Hercegovinë. Bashkimi Evropian ka të dërguar për këtë rajon diplomat Miroslav Lajçak.

Numri i të vdekurve në ShBA nga koronavirusi tejkaloi 800 mijë

NYU-JORK, 15 DHJETOR - Që nga fillimi i pandemisë më shumë se 800 mijë amerikanë vdiqën në ShBA si pasojë e koronavirusit, tregojnë rezultatet e Institutit "Johns Hopkins". Të dhënat u publikuan në kohën kur në ShBA u konfirmuan 50 milionë raste me Covid-19. Shumica e të vdekurve ishin qytetarë të pavaksinuar dhe të moshuar, kurse raportohet se më shumë amerikanë vdiqën përgjatë vitit 2021 sesa në 2020-n.

Rreth 450 mijë raste të vdekjeve ndodhën në vitin 2021 pavarësisht prej faktit që vaksinat kundër koronavirusit u miratuan qysh në dhjetor 2020.

Mesatarja ditore e të vdekurve në ShBA është 1 150 persona, tregojnë të dhënat e Qendrës për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (CDC) e 100 mijë të



vdekur raportohet se ndodhën në 11 javët e shkuara.

Përndryshe, kaluan më shumë se 650 ditë që nga koha kur pacienti i parë në ShBA ka vdekur nga Covid-19, rast i raportuar në Siatwll.

Totali i 800 mijë të vdekurve paraqet shifër më të lartë sesa popullsia e qyteteve si Boston. Shteti tjetër me shifër të lartë të të vdekurve është Brazili me më shumë se 616 mijë të vdekur dhe India me mbi 475 të vdekur. Sa i përket numrit të të vdekurve për kokë banori, ShBA-ja renditet e njëzeta, thonë nga Instituti "Johns Hopkins". Numri i të vdekurve në ShBA kishte rënë dukshëm në pranverën e shkuar kur vaksinat ishin të qasshme për të gjithë, por u rrit sërish përgjatë verës kur vendi ballafaqohej me variantin e koronavirusit "Delta".

Policia gjermane heton kërcënimet me vdekje ndaj kryeministrit të Saksonisë

DRESDEN, 15 DHJETOR - Policia gjermane kreu bastisje në disa lokacione si pjesë e hetimeve të kërcënimeve të raportuara me vdekje. Sipas medieve gjermane, policia kishte marrë informata për kërcënime me vdekje që i ishin bërë kryeministrit të Saksonisë dhe zyrtarëve të tjerë nga kundërshtarët e vaksinimit kundër koronavirusit dhe masave kundër përhapjes së pandemisë.

Disa prona në Dresden u bastisën nga policia si pjesë e hetimit ndaj përgatitjes së mundshme të disa

sulmeve të dhunshme, njoftoi policia në "Twitter".

Hetimet u nxitën pas një raporti të javës së shkuar në televizionin ZDF, sipas të cilit, një grup njerëzish diskutonin rreth mundësisë që ta vrisnin kryeministrin e shtetit gjerman të Saksonisë, Michael Kretschmer. Këtë bisedë ky grup e bëri në shërbimin për mesazhe, "Telegram". Plani ishte që përpos Kretschmerit, të vriten edhe politikanë të tjerë, raporton AP. Dresdeni është kryeqyteti i shtetit federal gjerman, Saksoni dhe, së

fundmi, në qytet pati shumë protesta kundër politikave që kanë për qëllim parandalimin e përhapjes së pandemisë. Për më tepër, në këtë shtet niveli i vaksinimit të qytetarëve kundër koronavirusit është më i ulët në gjithë Gjermaninë. Sipas raporteve, grupi përbëhej nga 103 njerëz dhe të gjithë kundërshtonin vaksinimin. Policia njoftoi se, pas bastisjeve, komentet e disa prej këtyre qytetarëve rreth posedimit të armëve, po ashtu, janë pjesë e hetimit.



ËSHTË MBAJTUR KONFERENCA E TETË STATUSORE NDAJ ISH-KRERËVE TË UÇK-së

Mbrojtja, ankesa ndaj ZPS-së sa i përket nxjerrjes së materialeve

Mbrojtja e ish-krerëve të UÇK-së ka drejtuar të mërkurën ankesa ndaj Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) sa i përket nxjerrjes së materialeve. Avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka thënë se deri më tani mbrojtja ka marrë 13 800 prova dhe më shumë se 11 000 prej tyre i ka marrë pas afatit për nxjerrje të materialeve të 23 korrikut të këtij viti. Ndërkaq avokati i ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçit, Gregory Kehoe, ka pasur mjaft kritika ndaj ZPS-së sa i përket mospranimin të garancisë së Policisë së Kosovës për lirimin me kusht të Thaçit dhe të tjerëve

HAGË, 15 DHJETOR (ER) - Në Dhomat e Specializuara në Hagë është mbajtur konferenca e tetë statusore ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi. Ata akuzohen nga Zyra e Prokurorit të Specializuar për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Në konferencën statusore që është mbajtur të mërkurën, të pandehurit nuk kanë marrë pjesë fizikisht në Dhomat e Specializuara, por e ndiqnin atë përmes videolidhjes. Në fillim të konferencës, avokati i Thaçit, Gregory Kehoe, ka thënë se, pavarësisht se sot gjykata mori

vendim për mbajtjen në paraburgim të klientit të tij, mbrojtja do ta apelojë vendimin. Por, për shkak të festave të fundvitit, ai kërkoi që të shtyhen afatet e apelimit. "Nga gjykatat e mëparshme janë liruar serbë dhe shqiptarë, por nga kjo gjykatë jo", ka thënë ai, duke shtuar ata do t'i respektonin kushtet e lirimin nga paraburgimi dhe ka kërkuar seancë dëgjimore publike për t'i trajtuar arsyet se pse të pandehurit mbahen në paraburgim për një vit dhe për dilemat që ka Zyra e Prokurorit të Specializuar lidhur me Policinë e Kosovës, e cila do të ishte përgjegjëse për sigurinë e të pandehurve nëse ata do të

ktheheshin në Kosovë. "Nuk paska asnjë kusht që garanton që këta individë do të paraqiten në gjykatë në kohën e duhur dhe se do ta respektojnë çdo vendim tuajin. Kjo procedurë duhet të shqyrtohet, pra me debat të hapur, të shohim se cilat janë rezervat që ka prokuroria mbi Policinë e Kosovës. Pra, kërkojmë seancë dëgjimore, që t'i dëgjojmë se pse këta burra po e presin gjykimin këtu dhe të merremi me kushtet e vendosura", ka thënë ai.

Zyra e Prokurorit të Specializuar njoftoi se besojnë që deri në afatin e 31 janarit të vitit të ardhshëm t'i nxjerrë materialet. ZPS-ja ka theksuar se nga 11 300

materiale, 545 ende nuk janë përkthyer në shqip. Po ashtu, kjo zyrë ka pohuar se po punon në për krijimin e entiteteve për dëshmitarët e mbrojtur. Mbrojtja e mirëpriti krijimin e entiteteve apo rubrikave për informacionet rreth dëshmitarëve.

Ndërkaq, avokati i Veselit, Ben Emmerson, ka thënë se deri më tani mbrojtja ka marrë 13 800 prova dhe më shumë se 11 000 prej tyre i kanë marrë pas afatit për nxjerrjen e materialeve të 23 korrikut të këtij viti. "Ky volum rritet gjithmonë para konferencave të ecures së çështjes. Sa ka materiale të tjera për t'ju dhënë, që të kemi një ide se sa duhet të presim. A do të marrin një volum të madh të materialeve në janar?", pyeti ai. "Besoj se ndoshta do të na duhet shumë kohë në vitin e ardhshëm vetëm për të lexuar një pjesë të materialeve", ka thënë mbrojtësi i Veselit.

Avokati i Selimit, David Young, ka thënë se Zyra e Prokurorit të

Specializuar po vazhdon që të dërgojë materiale për dëshmitarët, por nuk po tregojnë se cilat materiale i përkasin cilit dëshmitar. Deri më tani mbrojtja, tha ai, ka pranuar mbi 200 pako materiale për dëshmitarët.

Mbrojtja e ish-krerëve të UÇK-së u ankua se sistemi 'legal workflow', ku ZPS-ja ndan me mbrojtjen provat që ka, nuk po funksionon si duhet.

Avokatët e ish-krerëve të UÇK-së, po ashtu, theksuan se Zyra e Prokurorit të Specializuar ka vendosur që të mos përdorë rreth 30 000 materiale, që fillimisht kishte thënë se janë materiale provuese, që avokatët do të mund t'i përdornin për ta përgatitur mbrojtjen për klientët e tyre.

Konferencën statusore, apo konferencën mbi ecurinë e çështjes, e thërret gjykatësi i procedurës paraprake dhe ajo ka për qëllim organizimin e shkëmbimeve ndërmjet palëve. Në këtë konferencë Prokuroria tregon çfarë lloji të provave ka.



11 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 15 DHJETOR (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të mërkurën se, sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, prej 1 985 testimëve të kryera, 11 qytetarë kanë dalë pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes.

Të mërkurën janë shëruar edhe 11 qytetarë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve është 157 925.

Në total numri i rasteve aktive është 314.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 2 413 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 650 162 doza të vaksinës. Deri më sot 774 547 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.





PRESIDENTI I MAQEDONISË SË VERIUT, STEVO PENDAROVSKI, KA VIZITUAR TË MËRKURËN KOSOVËN

Osmani dhe Pendarovski dyshojnë në suksesin e "Ballkanit të hapur"

Presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, dhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, kanë shprehur skepticizëm për suksesin e iniciativës rajonale "Ballkani i hapur". Gjatë vizitës në Kosovë, Pendarovski ka deklaruar se iniciativa nuk mund të ketë sukses përderisa në të nuk janë të përfshira të gjitha vendet e rajonit. Ndërsa presidentja Osmani ka thënë se iniciativa nuk e pranon trajtimin e barabartë të gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor. Në takim me të parin e Maqedonisë së Veriut, Osmani dhe Kurti kanë ngritur shqetësimin për militarizimin e Serbisë

përfshin të gjitha shtetet, nuk do të sukses", ka deklaruar Pendarovski. Sipas tij, kjo iniciativë rajonale nuk mund ta zëvendësojë asnjëherë Procesin e Berlinit. "Qëndrimi im është se mund të jetë vetëm një nga mjetet për përmirësim tregtar dhe ekonomik, por jo politik. Mund të jetë vetëm pjesë e Procesit të Berlinit, por jo ta zëvendësojë atë. Procesi i Berlinit është iniciativë që ka institucione, ka resurse që 'Ballkani i Hapur' nuk i ka", është shprehur Pendarovski. Dyshime më të mëdha ndaj "Ballkanit të hapur" ka shprehur presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani. Ajo ka thënë se kjo iniciativë nuk është ndërtuar mbi parimet themelore të bashkëpunimit ndërfqinjësor. Sipas Osmanit, kjo iniciativë nuk e pranon trajtimin e barabartë të gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor. "Përderisa Serbia nuk e trajton Kosovën në mënyrë të barabartë në iniciativa rajonale, atëherë

shohim se Serbia do zgjerim të interesave të saj hegjemoniste. Kosova ka rezerva të mëdha sa iu përket aspekteve politike të kësaj iniciative, por edhe sa i përket ekonomisë dhe sigurisë sepse synimi është të përdoret njëfarë paradhome që të zvarritet procesi i integritetit evropian", ka deklaruar Osmani. E para e vendit ka folur edhe për rreziqet që i kanosen rajonit nga Rusia. "Kosova dhe rajoni ballafaqohen me rreziqe të mëdha për shkak të tendencave destabilizuese të Ruisë nëpërmes Serbisë. Kosova është e përkushtuar jo vetëm t'i refuzojë ndikimet dashakeqe, por edhe të bashkëpunojë me partnerët tanë që të parandalohen ndikimet e këtitla destabilizuese. Rajonit i duhet ecje me hapa konkretë drejt integritetit evropian, por edhe paqe e stabilitet afatgjatë. Por, krejt kjo dëmtohet nëse ndikimi i Ruisë rritet nëpërmes trampolinës së saj, Serbisë", është shprehur ajo.

Maqedonia e përkrah perspektivën evropiane të Kosovës

Presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, edhe një herë ka bërë me dije se vendi i tij e përkrah Kosovën në të gjitha proceset euroatlantike. "Maqedonia e Veriut i mbështet aspiratat euroatlantike të Kosovës dhe në këtë kontekst jemi në dispozicion që t'i tregojmë përvojat tona si për integrim në BE ashtu edhe në NATO", ka deklaruar Pendarovski. Ai i ka dhënë mbështetje Kosovës edhe në procesin e dialogut me Serbinë. "E dimë që procesi është i vështirë dhe i komplikuar, por shtetet e rajonit me qëllim të mirë e mbështetin zgjidhjen e kontestit. Maqedonia e Veriut do ta mbështesë marrëveshjen finale mes dy vendeve sepse, sipas nesh, ajo do të kontribuojë në stabilitet në rajon", ka

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 15 DHJETOR - Presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, dhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, kanë shprehur rezervat e tyre për iniciativën rajonale "Ballkani i hapur". Në një konferencë të përbashkët për medie, presidenti maqedonas ka deklaruar se kjo iniciativë nuk

mund të ketë sukses përderisa në të nuk janë të përfshira të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.

Ai ka treguar se ndaj iniciativës ka pasur rezerva qysh në fillimet e saj. "T'jua rikujtoj se kur nisi si iniciativë në vitin 2019, unë isha politikani i parë që shpreha rezerva. Kësaj iniciative i mungon diçka, në vend se të jenë gjashtë shtetet, janë vetëm tri. Derisa kjo iniciativë nuk i

Kushtetuesja shfuqizon vendimin për shkarkimin e pesë anëtarëve të KPMSHCK-së

PRISHTINË, 15 DHJETOR (ER) - Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar vendimin për shkarkimin e pesë anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK). Në njoftimin për medie thuhet se Gjykata Kushtetuese ka pranuar kërkesën e dhjetë deputetëve të Kuvendit të Kosovës. "Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës shqyrtoi kërkesën KO 127/21, të parashtruar nga Abelard Tahiri dhe dhjetë deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në të cilën u kërkua që të bëhet vlerësimi i

kushtetutshmërisë së Vendimit [nr. 08-V-029], të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 30 qershorit 2021, për shkarkimin e pesë anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës", thuhet në njoftim e Kushtetueses.

Më tej, në njoftim thuhet se në vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar të Kuvendit, Gjykata njëzëri vendosi që "(i) kërkesa është e pranueshme; (ii) vendimi [nr. 08/V-029] i 30 qershorit 2021 i Kuvendit nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të

Kushtetutës; (iii) të shfuqizojë vendimin e lartcekur; (iv) të shfuqizojë masën e përkohshme të përcaktuar përmes vendimit të gjykatës, të 21 tetorit 2021; dhe (v) të refuzojë kërkesën për seancë dëgjimore". "Gjykata rikujton që më 30 qershor 2021, duke u bazuar në rekomandimin e Komisionit të Kuvendit për Administratë Publike, Kuvendi votoi për shkarkimin e pesë anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Duke kontestuar kushtetutshmërinë e këtij akti, parashtruesit e kërkesës, ndër të tjera, pretenduan para Gjykatës se vendimi i kontestuar i Kuvendit, cenon pavarësinë e

Këshillit, të garantuar me nenin 101 [Shërbimi Civil] dhe me nenin 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, duke theksuar se Këshilli, si organ i pavarur kushtetues, nuk mund t'i nënshtrohet ndërhyrjeve nga ana e Kuvendit dhe se për shkarkimin kolektiv të anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, nuk janë përmbushur asnjë nga kriteret e përcaktuara përmes Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Pretendimet e dorëzuara në gjykatë nga një deputet i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje!, ndër të tjera,

theksojnë se Kuvendi në nxjerrjen e vendimit të kontestuar ka vepruar në përputhshmëri me funksionin e tij mbikëqyrës, ndërsa rasti i ngritur para Gjykatës, nuk ngërthen çështje kushtetuese", ka njoftuar Kushtetuesja.

Paraprakisht, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, pas vlerësimit të kushtetutshmërisë së vendimit të Kuvendit, për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më 27 tetor 2021 kishte vendosur masën e pezullimit të përkohshëm të këtij vendimi deri më 15 dhjetor të këtij viti.



Aktakuzë për organizim dhe pjesëmarrje në grup terrorist

PRISHTINË, 15 DHJETOR (ER) - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamentin Special, kundër një të

pandehuri me inicialet F. D. për shkak të veprës penale "Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist" nga neni 143, paragrafi 2 i KPRK-së. Prokuroria Speciale njofton se i pandehuri F. D., me

paramendim, me dashje, si dhe me përgatitje paraprake, me qëllim që t'i bashkëngjitet organizatës terroriste ISIS, ka depërtuar në brendi të Sirisë, si dhe pas regjistrimit në këtë

organizatë, ka marrë pjesë aktive në luftërat e Sirisë. Me këto veprime i pandehuri F. D. ka kryer veprën penale "Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist" nga neni 143, paragrafi 2 i KPRK-së.



deklaruar Pendarovski.

Kurse presidentja Osmani e ka falënderuar homologun maqedonas për përkrahjen e vazhdueshme që vendi i tij i ka dhënë Kosovën në procesin e integritimit evropian, por edhe në NATO, aty ku Maqedonia e Veriut tashmë është anëtare. "E falënderoj gjithë shtetin për kontributin e dhënë që Kosova të ecë përpara, për mbështetjen që

na jep për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, aty ku Kosova edhe e ka vendin, por edhe për kontributin në kuadër të misionit të KFOR-it", ka deklaruar Osmani. Sipas saj, BE-ja nuk e ka mbajtur premtimin për liberalizim të vizave për qytetarët e Kosovës. "BE-ja ende nuk e ka mbajtur premtimin për liberalizim dhe, në të njëjtën kohë, e falënderoj këtë shtet për qasjen

ndaj Kosovës për liberalizimin e vizave. Të dyja shtetet e kemi të njëjtin synim drejt Bashkimit Evropian", ka thënë presidentja Osmani.

Gjatë vizitës në Kosovë, presidenti maqedonas është takuar edhe me kryeparlamentarin Glauk Konjufca dhe kryeministrin Albin Kurti.

Tema qendrore në takim ishte Kurtit me Pendarovskin ka qenë

avancimi i mëtejshëm i raporteve në mes të dy vendeve. "Ekziston vullnet i qartë politik nga ana e Republikës së Kosovës për ta rritur koordinimin ndërinstitucional dhe për t'i thelluar më tej raportet tona dypalëshe", ka thënë kryeministri Kurti, sipas komunikatës për medie të qeverisë.

Ai ka theksuar interesimin e Qeverisë së Republikës së

Kosovës për t'i koordinuar politikën në fushën e sigurisë, në atë të mbrojtjes dhe në politikën e jashtme, në linjë me orientimin euroatlantik dhe në linjë me raportet e shkëlqyeshme tregtare. Edhe kryeministri Kurti ka ngritur shqetësimin për militarizimin e Serbisë. Sipas tij, kjo paraqet kërcënim për rajonin, paqen dhe stabilitetin në Ballkan.

Ndërveprimi i përmirësuar në mes të nivelit qendror dhe lokal, pjesë e rëndësishme e konsolidimit të demokracisë

PRISHTINË, 15 DHJETOR (ER) - "Për Republikën e Kosovës avancimi i demokracisë sonë është i një rëndësie të veçantë, dhe një demokraci më e mirë në nivelin lokal e një ndërveprim i përmirësuar në mes të nivelit qendror dhe atij lokal është pjesë e rëndësishme e konsolidimit të demokracisë dhe të shtetësisë së vendit tonë", ka thënë kryeministri Albin Kurti në ceremoninë përmbyllëse të projektit të Këshillit të Evropës "Promovimi i demokracisë vendore".

Kurti shpreson që Këshilli i Evropës do të mobilizojë burime dhe do të kërkojë një zë të përbashkët për t'u angazhuar me Kosovën pavarësisht prej dallimeve. "Demokracia lokale do të thotë që qytetari angazhohet për të siguruar që politikat lokale reflektojnë nevojat dhe preferencat e komunitetit e jo të kryetarit të komunës. Ajo kërkon pjesëmarrje aktive qytetare në mënyrë që pushteti të mos bëhet arbitrar dhe i korruptuar apo të funksionojë vetëm për disa", ka thënë kryeministri Kurti.

Ai ka shtuar se si qytetarë të Kosovës nuk pushojnë së kërkuari të drejta në pajtim me parimet demokratike dhe

karakterin republikan të shtetit. "Si banorë të komunës duhet të kërkojmë shërbime më të mira, por edhe ta kryejmë pjesën e angazhimit tonë si qytetar duke marrë pjesë jo vetëm ditën e zgjedhjeve, por çdo ditë kur merren vendimet e kur zbatohen ato", ka theksuar ai.

Duke biseduar për nivelin e demokracisë në komunat në veri të vendit tonë, kryeministri Kurti ka thënë se është evidente se qytetarët e Republikës së Kosovës nga komuniteti serb janë në trysni të vazhdueshme nga struktura të trashëguara ilegale dhe kriminale të cilat veprojnë jashtë ligjit dhe pengojnë zhvillimin e demokracisë dhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në institucionet e republikës.

Ai ka thënë se këto çështje do të adresohen përmes programit të qeverisë për sundim të ligjit dhe dialogut të qeverisë me komunitetet joshumicë në Kosovë.

Projekti "Promovimi i demokracisë lokale", i filluar nga Këshilli Evropës në korrik të vitit të kaluar, ka synim përmirësimin e qeverisjes lokale, ku për herë të parë Kosova është vendosur nën vëzhgimin e Kongresit të Autoriteteve Lokale e Rajonale.



Maloku dhe Lumezi vizitojnë institucionet e drejtësisë në Strasburg



Prishtinë, 15 dhjetor (ER) - Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, kanë zhvilluar një vizitë katërditëshe në Strasburg, të cilën e ka organizuar Këshilli i Evropës.

Në kuadër të kësaj vizite, kryesuesi i KPK-së, Maloku dhe kryeprokurori i Shtetit, Lumezi, kanë zhvilluar aktivitete të ndryshme, me ç'rast janë takuar me përfaqësuesit e Këshillit të Evropës, Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Komisionarin për të Drejtat e Njeriut dhe Komitetit Evropian

për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues (CPT). Në këto takime udhëheqësit e sistemit prokurorial të Kosovës, Maloku dhe Lumezi, diskutuan për një sërë temash me interes të cilat ndërliqhen me interpretimin e konventave të ndryshme evropiane, punën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, zbatimin e vendimeve të GjNDNJ-së dhe praktikave të saj të mira, bashkëpunimin me vendet anëtare të KE-së në luftën kundër torturës dhe në mbështetje të sistemit të

drejtësisë penale, rekomandimet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues dhe transformimet digjitale të institucioneve gjyqësore dhe prokuroriale.

Në përmbyllje të vizitës në Strasburg u tha se këto institucione dhe mekanizmat e tjera evropiane të drejtësisë mirëpresin bashkëpunimin e ndërsjellë me përfaqësuesit e organeve të drejtësisë të Kosovës dhe do të jenë gjithnjë në mbështetje të zhvillimit dhe avancimit të mëtejshëm të tyre.

Lutfi Haziri, përgjegjës i LDK-së për dialogun me Serbinë

Prishtinë, 15 dhjetor (ER) - Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lutfi Haziri, ka marrë detyrë të re në këtë parti. Ai do të jetë përgjegjës i LDK-së për dialogun me Serbinë. "Dialogu është ndër prioritetet e para të LDK-së. Duke qenë kështu, po e bëj publike që me kërkesën e kryetarit të LDK-së, Lumir Abdixhiku, unë do të jem

përgjegjës për dialogun dhe bashkëpunimin regjional", ka shkruar Haziri në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka theksuar se është paralajmëruar nga autoritetet ndërkombëtare që Ballkani Perëndimor nuk mund të vazhdojë të jetojë në këto tensione dhe me këtë kërcënim si 'bombë' e kurditur në Evropë. "Kështu që, po

krijohet një momentum i ri për Ballkanin që në kërthizë të krejt problemit ka me qenë Kosova dhe Serbia dhe ka ardhur koha që problemet të zgjidhen njëherë e përgjithmonë, për t'i hapur rrugë të ardhmes së Kosovës, që është Bashkimi Evropian, anëtarësimi në NATO dhe në miqësi permanente me ShBA-në!", ka shkruar Haziri.



Aksion i policisë në Karaçevë, konfiskohen aparate të bixhozit dhe rrënohen objektet ilegale

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

GJILAN, 15 DHJETOR - Drejtoria Rajonale e Policisë e Kosovës në Gjilan, në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorinë Themelore në Gjilan, të mërkurën kanë ekzekutuar urdhërkontroll në fshatin Karaçevë, komuna e Dardanës. Operacioni policor ka filluar që në orët e hershme të mëngjesit si rezultat i një hetimi në vazhdimësi dhe të bashkërenduar mes Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë Themelore në Gjilan, lidhur me pretendimet për veprimtari të paligjshme, përfshirë bixhozin e paligjshëm dhe aktivitete të tjera. Në këtë rast janë arrestuar dy persona të cilët janë intervistuar në prani të avokatëve mbrojtës dhe me urdhër të prokurorit të shtetit të dyshuarit janë ndaluar për 48 orë. Si vazhdimësi e operacionit janë kontrolluar shtëpitë dhe objektet përcjellëse

ku jetojnë të dyshuarit si dhe objektet e tjera ku janë zhvilluar veprimtaritë e lojërave të fatit.

Gjatë kontrollit janë gjetur dhe sekuestruar, në cilësinë e provave materiale: 96 aparate të lojërave të fatit, katër shtëpiza kompjuteri, tre llaptop, tre monitorë, dy TV që janë përdorur për lojëra të fatit, një pistoletë e llojit "Ekol" special 99 së bashku me 17 fishekë, një gjenerator si dhe 469,15 euro (të gjetura në aparatet e lojërave të fatit). Të gjitha aparatet (96 copë) dhe një gjenerator sipas procedurave të parapara i janë dorëzuar Doganës së Kosovës për procedura të mëtutjeshme.

Në vendngjarje në fshatin Karaçevë, Inspeksioni Komunal i komunës së Dardanës ka asistuar Policinë e Kosovës për rrënimin e tri objekteve të cilat janë ndërtuar pa leje në të cilat kanë qenë duke ushtruar veprimtaritë e kundërligjshme të lojërave të fatit. Lidhur me këtë rast hetimet janë në vazhdim e sipër dhe në kërkim




të personave të tjerë si të dyshuar të mundshëm të përfshirë në këtë rast.

Rasti është duke u hetuar nga Drejtoria Rajonale e Policisë së Kosovës në Gjilan në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorinë Themelore, përfshirë edhe kërkimin e disa personave të

tjerë si të dyshuar të mundshëm. Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka reaguar në lidhje me këtë aksion të policisë. "Edhe një aksion i suksesshëm i Policisë së Kosovës. Në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Gjilan dhe me autoritetet komunale të Dardanës sot u godit rrjeti i

kazinove ilegale në zonën e fshatit Karaçevë. Pas konfiskimit të aparateve për lojëra të bixhozit, u rrënuan objektet e ndërtuara ilegale si dhe arrestimet e personave të përfshirë në këtë aktivitet kriminal po vazhdojnë edhe në këto momente", ka thënë Sveçla.



Kriza energjetike, Abdixhiku: Qeveria Kurti, e paaftë dhe tallëse

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 15 DHJETOR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka reaguar në lidhje me krizën energjetike në vend, duke hedhur kritika në adresë të qeverisë Kurti. "Një krizë e paralajmëruar, një qeveri e paaftë, tallëse dhe e vonuar. Kriza e sotme energjetike është paralajmëruar tash e pesë muaj. Në mot të ngrohtë, institucionet energjetike, ekspertët e brendshëm e të jashtëm, pa dallim, kishin rekomanduar kontraktimin e energjisë elektrike përderisa çmimet ishin të lira; pesëfish më të lira sesa çfarë blejmë sot si shtet. Në atë kohë rekomandoheshin

edhe revitalizimet e blloqeve, subvencionimet e operatorëve, organizmi i prodhimit e planet kursyese si parapërgatitje për dimrin e ftohtë", ka shkruar Abdixhiku në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka thënë se këto paralajmërimet nuk ishin dëgjuar. "Në kohën kur vendet e rajonit bënin garë për blerjen e energjisë elektrike me çmim më të lirë, kryeministri ynë krekosej nëpër qendra rajonale dhe evropiane me narracione fiktive për zhvillimin të pashembull ekonomik që Kosova me të po e përjetonte", ka thënë Abdixhiku, duke shtuar se sot zhvillimi i pashembull ekonomik i Kurtit është pa rrymë. "Tani kë do të fajësojnë për këtë krizë? Një qeveri që i ka krejt, i ka edhe



njerëzit e vet të vendosur së fundmi në KEK e në çdo institucion tjetër energjetik, nuk arrin të sigurojë as një produkt bazë në këtë zhvillim të pashembull ekonomik", ka

deklaruar lideri i LDK-së. Abdixhiku ka thënë se kjo qeveri paaftësinë e saj po e drejton te qytetarët. "Për shpenzimin e energjisë në 'joystick', 'larje të dhëmbëve me ujë të ngrohtë', e

për vetë çmimin e lirë të energjisë. Tani edhe çmimi i energjisë na u bë i lirë. Kjo parahyrje e tyre është paralajmërim për shtrenjtimin e radhës që do të bëjnë. Por as shtrenjtimi i rrymës e as rekomandimet tallëse për kursim nuk do ta kapërcejnë këtë krizë që sapo ka nisur", është shprehur ai. Abdixhiku ka theksuar se Kosova po hyn në një dimër të shkurtimeve të energjisë, mungesës së ngrohjes, uljes së prodhimit të bizneseve e paaftësisë qeverisëse për t'u prirë problemeve me kohë. "Sot intervenimet e qeverisë janë të vonshme; sepse janë të vonshme janë edhe të shtrenjta; e sepse janë të shtrenjta janë edhe pa zgjidhje", ka thënë lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku.

Paralajmërohet gjendje e jashtëzakonshme me rrymë

PRISHTINË, 15 DHJETOR - Një ditë më herët ministrja e Ekonomisë e Kosovës, Artane Rizvanolli, ka paralajmëruar gjendje të jashtëzakonshme me energji elektrike në vend. Duke raportuar në Komisionin Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, Rizvanolli ka theksuar se situata është pasojë e çmimeve të larta të importit. Ajo ka thënë se për import të energjisë elektrike këtë vit janë paraparë 12 milionë euro, por këto mjete, sipas saj, janë shpenzuar vetëm në dy muaj. Rizvanolli ka deklaruar se nuk mund të ketë garanci se çmimi i rrymës nuk do të rritet. Fatura e energjisë elektrike në Kosovë mund të shtrenjtohet për 7 për qind në muajt e ardhshëm. Një rritje të tillë e ka kërkuar Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike (KEDS), ka bërë me dije për "Radion

Evropa e Lirë" zëdhënësi i saj, Viktor Buzhala. "Kemi bërë kërkesë për shqyrtim të jashtëzakonshëm të tarifave të energjisë elektrike. Kërkesa është që të rriten tarifat e energjisë elektrike për 7 për qind", ka thënë ai. Konsumatorët e Kosovës aktualisht paguajnë 6.75 centë për kilovat në orë. Ky çmim do të jetë deri më 1 prill të vitit 2022, nëse KEDS-i dhe Furnizuesit për Shërbim Universal për Energji Elektrike nuk kërkojnë nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) në Kosovë shqyrtim të jashtëzakonshëm të tarifave të energjisë elektrike. Kriza energjetike në botë ka nisur tash e sa muaj, kryesisht për shkak të mungesave të gazit dhe rritjes së çmimeve të gazit. Kriza globale energjetike ka bërë që Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut të shpallin tashmë gjendje të krizës energjetike.



Ngrohja nga "Termokos"-i rikthehet sot

Mungesa e avullit që çoi në ndërprerjen e ngrohjes për konsumatorët në Prishtinë nga ndërmarrja "Termokos" erdhi si pasojë e problemeve në njësinë B1 të termocentralit 'Kosova B'. Kjo është bërë me dije nga Korporata Energjetike

e Kosovës (KEK), përmes një postimi në rrjetin social "Facebook". Sipas planeve, KEK-u njoftoi se njësinë B1 pritet të kthehet në prodhim të enjten, më 16 dhjetor, "kur edhe do të krijohen kushtet për furnizimin e 'Termokos'-it me

avull për ngrohje qendrore". KEK-u, po ashtu, njoftoi se aktualisht në termocentralin 'Kosova A' gjendja është stabile, ku në punë janë të tria njësitë aktive (A3, A4 dhe A5) që prodhojnë rreth 390 megavat në orë. KEK-u sqaroi se po bën

përpjekje maksimale për prodhim të qëndrueshëm të energjisë elektrike. "Termokos"-i njoftoi të mërkurën se ndërpreu ngrohjen për të gjithë konsumatorët në Prishtinë për shkak të pamundësisë për t'u

furnizuar me avull nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK). "Kërkojmë mirëkuptimin e konsumatorëve tanë deri në përmirësimin e situatës dhe rikthimin e furnizimit me ngrohje", thuhej në njoftim.

Ndryshimet në çmim të vajit, deri në 84 për qind

PRISHTINË, 15 DHJETOR - Rritja e çmimeve më 2021 ka qenë e madhe. "Sakushton" ka monitoruar çmimet e prodhimeve ushqimore gjatë këtij viti dhe ka shënuar edhe rritjet e çmimit të disa artikujve. Rritjet e çmimeve në artikuj ushqimorë janë shumë të mëdha dhe ato shkojnë deri në 80 për qind. Mirëpo, duhet pasur parasysh se këto matje nuk paraqesin edhe lartësinë e inflacionit pasi çmimet e marra nga "Sakushton" përfshijnë çmimin më të ulët të një produkti që në një periudhë ka mundur të jetë në zbritje për shkak të fushatës apo afrimit të afatit të skadimit. Duke pasur parasysh se "Sakushton" operon vetëm vitin 2021, nuk mund të bëhet një krahasim me vitet e mëparshme. Për t'i përshkuar të dhënat tona më saktë duhet të thuhet se sa ka kushtuar një produkt më së liri e sa më së shtrenjti në vitin 2021.

Më poshtë mund t'i gjeni ndryshimet në çmim gjatë këtij viti dhe çmimet e këtyre prodhimeve të shitës të ndryshëm. Në ditët në vazhdim do t'i publikojmë edhe çmimet më të larta dhe më të ulëta të prodhimeve të tjera. Vaji i kuzhinës është një nga produktet me ndryshimin më të madh në çmim në vitin 2021. Vaji "Floil" është shitur më së liri 0.97 cent dhe 1.79 cent më së shtrenjti, një ndryshim prej 0.82 centësh apo 84 për qind. Tash mund të gjendet edhe me çmim prej 1.49 centësh. Një produkt tjetër themelor, që është mielli, gjithashtu ka pasur një ndryshim të madh në çmim gjatë shitjes në 2021. Mielli 'Finnesa' më së liri është shitur 0.69 centë për kilogram përderisa çmimi më i lartë i shitjes ka qenë 0.89 centë, apo ndryshim për 22 për qind. Tash ky produkt mund të blihet për 0.79 centë për kilogram. Një produkt që e ka ndryshimin



më të madh është sheqeri "Beta", që në zbritje gjatë këtij viti ka mundur të blihet edhe për 0.60 centë për kilogram përderisa më së shtrenjti është vënë në shitje për 0.99 centë për 1 kilogram. Çmimi më i lirë momentalisht

është 0.88 centë. Makaronat 'Divella' më së liri janë shitur 0.60 centë për paketim dhe më së shtrenjti 0.99 centë, një ndryshim prej 0.39 centësh, një ndryshim prej 60-përqindësh.

Qumështi 'Vita' këtë vit në zbritje është shitur për 0.65 centë përderisa çmimi më i lartë ka qenë 0.99 centë duke mos prekur çmimin prej 1.00 eurosh. Ndërsa tash mund të gjendet me 0.87 centë.

Qyteti më i vjetër në botë!



Kur mendojmë se cili është qyteti më i vjetër në botë, përgjigja në parim duhet të jetë e thjeshtë. Fitues është qyteti ekzistenca e të cilit mund të gjurmohet më larg në kohë, duke përdorur analizën me radiokarbon. Por, përgjigja nuk është dhe aq e thjeshtë nga sa duket.

Në fakt, çfarë nënkuptojmë kur flasim për “qytetin më të vjetër”? A është qyteti më i vjetër në botë një vend i banuar vazhdimisht? Apo qyteti i parë i ndërtuar nga njerëzit, që sot nuk ekziston më? Po qytetet që e filluan jetën si vendbanime të vogla, dhe u shndërruan në qytetës humë më vonë?

Xheriko, një qytet në Palestinë, quhet shpeshherë qyteti më i vjetër në botë. Të dhënat arkeologjike, tregojnë se ky qytet është banuar që 11 mijë vjet më parë. Rreth vitit nëntë mijë vjet p.e.s., aty u vendosën gjuetarët-mbledhës, ndërsa duke nisur nga viti 8000 p.e.s., në Xheriko nisi zhvillimi i bujqësisë.

Kjo duhet të nënkuptojë se Xheriko është qyteti më i vjetër në botë, apo jo? Jo plotësisht. Në vitin 7000 p.e.s., Xheriko nuk kishte zhvilluar ende artin e qeramikës, edhe pse njerëzit që jetonin atje ndërtonin mure dhe shtëpi duke përdorur gurët. Xheriko u shpopullua më vonë.

Nga fundi i mijëvjeçarit IV p.e.s., shohim rishfaqjen e mureve, por vetëm në vitin 2300 p.e.s., Xheriko nisi të zhvillonte një jetë urbane. Prandaj, ai nuk ishte qyteti më i vjetër i ndërtuar nga njeriu. Çatalhojok dhe Gëbekli Tepe

në Turqi, kanë treguar shenjat më të hershme të proto-qyteteve.

Në Gëbekli Tepe ka dëshmi të ndërtimit të kolonave. Ndërkohë, Çatalhojok nuk kishte rrugë. Për të hyrë në shtëpi njerëzit hipnin nga çatia. Këto vendbanime të lashta zbulojnë informacione të rëndësishme mbi shfaqjen e qyteteve. Por, atyre u mungonin ndërtesat publike, rrugët e mirëmbajtura, dhe një rrjet kompleks urbanizimi.

Do të kalonin disa mijëvjeçarë derisa qyteti i parë në botë, Uruk, të ngrihej në brigjet e lumit Eufrat në Irakun e sotëm. Ai ishte kryeqyteti i mbretit legjendar Gilgamesh, tregimet e të cilit janë përjetësuar në Eposin e Gilgameshit. Midis viteve 4000 dhe 3200 p.e.s., Uruk përjetoj një zgjerim të shpejtë, nga një vendbanim ruralo-bujqësor në një qytetërim të sofistikuar urban. Uruk ishte një qytet i madh me godina publike, një burokraci të madhe, me ushtri, rrugë, kanalizime publike, dhe një shoqëri të ndarë në klasa. Ai ishte qyteti më i madh në botë, me një popullsi prej 40 mijë banorësh që jetonin brenda qytetit, dhe 80 mijë të tjerë në zonat fqinje.

Fermerët nuk jetonin brenda qytetit. Popullsia e Urukut përbëhej nga skribët, artizanët, punëtorë e ndërtimit, punëtorët e tjerë, bukëpjekësit, kasapët, priftërinjtë dhe zyrtarët e qeverisë. Me zhvillimin e tij, në Uruk u shfaq një sistem shkrimi. Banesat në këtë qytet ishin shtëpi me oborr.

Qyteti kishte një sistem

kanalësh për transport, i ngjashëm me atë të Venecias. Po ashtu, Uruk kishte komplekse tempujsh kushtuar perëndeshave Inana dhe Anu. Ndërtesa më e famshme ishte Zigurati i Bardhë kushtuar Anusë. Kjo strukturë madhështore u ndërtua rreth vitit 4000 p.e.s.

Komplekset e tempullit kishin si funksione fetare ashtu edhe administrative. Uruk nisi të bjerë në fillim të shekullit IV, ndërsa në shekullin VIII u braktis fare. Pra, Uruk ishte qyteti i parë në botë, por cili është qyteti më i vjetër që banohet edhe sot?

Siç e përmendëm më herët, Xheriko përmbante disa nga vendbanimet më të vjetra njerëzore, por kjo nuk e bën domosdoshmërisht atë si qytetin më të vjetër. Gjatë epokës së bronzit, rreth vitit 2500 p.e.s., Xheriko kishte një pallat mbretëror dhe mure rrethuese të qytetit.

Por, gjatë epokës së bronzit të vonë, u plaçkit, u shkatërrua dhe u shpopullua. Xheriko u rindërtua prapë gjatë epokës së hershme të hekurit (viti 1100 p.e.s.), ndërsa u shkatërruar sërish, këtë herë nga babilonasit. Kur qyteti u pushtua nga persët, ata ia rikthyen lavdinë e dikurshme.

Aleksandri i Madh kishte dikur një pallat në Xheriko. Qyteti i qëndroi sprovave të kohës, dhe banohet ende sot nga rreth 20 mijë njerëz. Një kandidatët tjetër në këtë listë përmendet Damasku.

Ndërsa, vendbanimet më të vjetra në Damask datojnë që në mijëvjeçarin e VII p.e.s., atje nuk

ka ndonjë banim në shkallë të gjerë deri në fillim të mijëvjeçarit II p.e.s.

Alepo, metropoli tjetër i njohur në Siri, është qyteti më i vjetër në vend dhe një nga qytetet më të vjetra të banuara ende në botë. Në kohët e lashta qyteti njihet si Ebla, dhe nga fundi i mijëvjeçarit të tretë p.e.s. ishte shumë i zhvilluar. Ebla ishte qyteti i Hadadit, një perëndi e lashtë e stuhive.

Rrënojat e tempullit të Hadadit mund të shihen ende sot. Gjatë epokës së bronzit, Alepo qeverisej nga amorejtë, itanët dhe hititët. Asirianët e morën kontrollin e qytetit rreth shekullit VIII p.e.s., por më vonë u pushtua nga persët.

Alepo ishte një qendër e rëndësishme tregtare gjatë periudhës greko-romake (viti 323 p.e.s. – shekulli V) m dhe lulëzoi dhe nën sundimin islamik. U bë metropoli i tretë më i madh në Perandorinë Osmane, pas Kostandinopojës dhe Kajros. Mjerisht, Alepo përjetoj një humbje të konsiderueshme njerëzore dhe materiale gjatë luftës së fundit civile në Siri.

Sot, qyteti ka një popullsi prej 1.8 milion banorësh. Alepo është e njohur për industrinë e saj të endjes së mëndafshit dhe tekstilit.

Biblos është qytet në Liban me vendbanime që datojnë që nga viti 8800 p.e.s.. Nga viti 3000 p.e.s., Biblos ishte njëqendër metropolitane e lulëzuar dhe një burim kryesor i tregtisë së papirusit në botën antike. Në botën e lashtë, papirusi ishte mjeti i preferuar për të shkruar dhe grekët e quajtën qytetin


sipas fjalës së tyre për libra, Biblos. Fjala “Bibël” është marrë nga emri i këtij qyteti. Fenikasit e quajtën qytetin Gebal dhe ai ishte një qendër e rëndësishme fetare.

Pas tyre qyteti u sundua nga kananitët, egjiptianët, asirianët, persët dhe grekët. Biblos e humbi rëndësinë pas rënies së Perandorisë persiane Sasanide dhe ngritjes së kalifateve islamike. Por, pas Kryqëzatës së Parë në fundin e shekullit XI, u rivendos tregtia me Evropën. Më vonë, Biblos u pushtua nga osmanët dhe më vonë francezët. Si një nga qytetet më të vjetra të banuara në botë, i ka rezistuar provës së kohës. Sot, rajoni metropolitani i Biblos ka një popullsi prej 100 mijë banorësh. Në listën e qyteteve më të vjetra duhen përmendur Varanasi në Indi, Plovdivi në Bullgari dhe Athina në Greqi. Këto qytete datojnë që në epokën e bronzit të vonë (1600-1200 p.e.s.) dhe janë ende të banuara.

Por, a kemi një përgjigje përfundimtare se cili është qyteti më i vjetër në botë? Sipas përkufizimit të Bankës Botërore, që një vendbanim të quhet qytet, ai duhet një popullsi prej të paktën 50 mijë banorësh. Xheriko nuk e arrin këtë numër, prandaj mund të përjashtohet si “qyteti më i vjetër në botë”.

Alepo është një pretendent i fortë. Por, bazuar në kriteret e të pasurit një kulturë të sofistikuar urbane, e cila mbijetoj dhe evoluoi me kalimin e kohës, atëherë fituesi është Biblos. Ai ishte një qytet i plotë që në vitin 3000 p.e.s. /Përgatiti: Bota.all/

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT
 Pilkington
 Envert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com




**QENDRA SPORTIVE
 'BUJQËSIA'
 TEL: 045/82 82 82**



Prizrenasit fitojnë përballjen ndaj prishtinasve. Drita e përfundon stinorin pa fitore



Në një ndeshje shumë interesante, Prizreni 16 ka mundur Sigal Prishtinën me rezultat 102:88 (26:20, 29:17, 14:29, 33:22), në kuadër të javës së 14-të për Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll.

Në pesë minutat e para të ndeshjes u zhvillua një lojë e barabartë, por më pas prizrenasit shkëputen në 21:13, ndërsa çerekun e parë e fituan 26:20. Vendasit vazhduan me lojë të mirë edhe në periudhën e dytë, duke e thelluar edhe më shumë epërsinë, ndërsa shkuan në pushim mes pjesëve me rezultat 55:37.

Por, bardhekaltrit nuk u dorëzuan dhe hynë furishëm në pjesën e dytë, përkatësisht periudhën e tretë, ku ngushtuan shifrat në vetëm tri pikë, 69:66, sa ishte rezultati pas 30 minutash. Ndeshje shumë interesante u zhvillua në dhjetë minutat e fundit, me mysafirët që afroreshin në rezultat dhe shkëputjen e vendasve. Dy minuta nga fundi, prishtinasit

afruan rezultatin në 93:88, por në momentet e fundit, prizrenasit ishin më të vëmendshëm dhe triumfuan 102:88. Te Prizreni 16 u dalluan Ivan Koljeviq me 24 pikë e tetë asistime, Courtney Fells me 14 pikë, 11 pikë, tetë asistime, Michael Green me 21 pikë dhe Alban Veseli me 20 pikë e shtatë kërcime, kurse te Sigal Prishtina u dallua Nick Tomsick me 20 pikë me pesë asistime.

Prizreni 16 ka nëntë fitore dhe katër humbje, ndërsa Sigal Prishtina ka shtatë fitore dhe shtatë humbje. Ndërsa Bashkimi e ka mundur Dritën, në takimin që u zhvillua në Prizren, për shkak të problemeve të gjilanasve me palestrën. Prizrenasit shënuan fitore me shifrat 83:112 (16:24, 29:27, 20:36, 18:25), në kuadër të xhiros së 14-të në Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll. Ndeshjen më mirë e nisën prizrenasit, duke pasur epërsi deri në 13 pikë, 8:21, dhe ishin më të mirë në çerekun e parë, duke e fituar këtë pjesë 16:24. Periudha e dytë

ishte shumë më e baraspeshuar, me gjilanasit që u rikthyen shpejt dhe arritën të ngushtojnë shifrat në 45:46, ndërsa pjesa e parë përfundoi me rezultat 45:51. Dallimi i madh dhe vendimtar u bë në periudhën e tretë. Prizrenasit ishin shumë më të mirë në këtë pjesë, duke u shkëputur në 20 pikë, 51:71, ndërsa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 65:87. Në dhjetë minutat e fundit, basketbollistët e Bashkimit menaxhuan lojën dhe epërsinë, duke triumfuar me shifrat 83:112. Te Drita u dalluan Qëndrim Demi me 29 pikë e 10 kërcime dhe Isaiah Johnson me 19 pikë e 10 kërcime, kurse te Bashkimi u dalluan Andi Shehu me 22 pikë e 10 kërcime, Julien Lewis me 20 pikë, pesë kërcime dhe tetë asistime, si dhe Bunjaku me 24 pikë, pesë kërcime dhe tetë asistime. Drita e përfundon stinorin vjeshtor me 14 humbje në 14 ndeshje, duke qenë skuadra e vetme pa fitore në elitë, kurse Bashkimi ka tetë fitore dhe gjashtë humbje.

SHKURT

Krasniqi mund të fitojë një milion euro pas procesit gjyqësor

Boksieri Robin Krasniqi humbi duelin brenda ringut me Dominic Bosel gjatë muajit tetor. Vendimet e gjyqtarëve ishin të dyshimta dhe Krasniqi iu drejtua gjykatës për të vërtetuar se ai kishte të drejtë dhe gjyqtarët dhanë pikët gabim. Një panel i gjyqtarëve javën e kaluar vërtetuan se Krasniqi e kishte fituar. Të pesë gjyqtarët e vlerësuan luftën me 116:112 dhe 115:114 për Krasniqin. Tani do të mbetet në dorën e gjykatës nëse do të vendoset që rripi të kthehet te Robin Krasniqi. Nëse kjo ndodh, Krasniqi do të arkëtojë rreth një milion euro.

Bajramin e kërkojnë Lazio dhe Unioni i Berlinit

Nedim Bajrami është një nga lojtarët më të rëndësishëm të Empolit. Futbollisti shqiptar ka cilësi mjaft të mira teknike, çka e bënë të dëshiruar për shumë skuadra. 23-vjeçari po lë gjurmët e tij edhe në Serinë A dhe ofertat për të pritet të mos mungojnë, duke marrë parasysh faktin se momentalisht është xhevahiri më i çmuar për Empolin. Në dyert e klubit italian pritet të trokasin jo vetëm nga Seria A, por edhe nga Gjermania. Sipas asaj që raportohet në Itali, Bajrami ka tërhequr interesin e Lazios, që me shumë mundësi do të hidhet në aksion që në muajin janar. Ndërkohë mesfushori shqiptar pëlqehet edhe nga Unioni i Berlinit, megjithëse një ofertë e tillë ndoshta nuk do ta bindte Nedim Bajramin.

PSG-ja interesohet për Comanin dhe Rudigerin

Paris Saint-Germain pritet të përforcohet në afatin kalimtar të janarit, por edhe në atë të verës. "Calciomercato" raporton se PSG-ja është e interesuar fillimisht për yllin e Bayern Munchenit, Kingsley Coman, i cili shihet si një zëvendësues ideal për Mbappen që mund t'i bashkohet Real Madridit. Në anën tjetër, klubi francez ka shfaqur interesim edhe për mbrojtësin e Chelsea, Antonio Rudiger. Ky i fundit pëlqehet edhe nga Reali i Madridit.

Alonso dhe Vetteli: Titulli të ndahet për të dy pilotët

Piloti spanjoll Fernando Alonso dhe ai gjerman Sebastian Vettel, dy kampionë bote në garat e Formula 1, kanë bërë një propozim të veçantë në lidhje me kampionatin e sapopërfunduar. Ata propozojnë që titulli kampion bote për pilot për vitin 2021 të ndahet mes Max Verstappenit (Red Bull) dhe Lewis Hamiltonit (Mercedes).

"Max është fantastik dhe titulli kampion për të ishte çështje kohe. Gjithsesi, mendoj se ishte me fat, pasi pa makinën e sigurisë do ta triumfonte Hamilton. Kjo është një çështje që do të zgjasë shumë, por duke parë 22 garat e këtij sezoni, secili prej tyre mund të shpallej kampion", ka thënë Alonso, dy herë kampion bote.

"Ndaj, mendoj se ky trofe mund të ndahet mes të dyve dhe kjo do të ishte më e drejtë, pasi të dy ishin të jashtëzakonshëm këtë sezon", ka shtuar Alonso, që mbështetet në këtë nismë edhe nga Vetteli, 4 herë kampion bote. "Jam i lumtur për Max, por edhe i dëshpëruar për Lewisin, pasi të dy e meritonin atë titull", u shpreh piloti gjerman.

Zhegrova: Herët a vonë do të luaj për Barcelonën

BASEL, 15 DHJETOR - Edon Zhegrova ka këmbëngulur se do të bëjë gjithçka për ta arritur qëllimin jetësor, të luajë për Barcelonën një ditë. Anëtar i Përfaqësueses së Kosovës është pjesë e Baselit në Superligën e Zvicrës që prej vitit 2019 kur e bëri hapin e parë në futbollin evropian

por, pavarësisht prej mungesës së interesimit nga klube më të mëdha, ai është i bindur për hapin e madh në karrierë.

Zhegrova ka bërë me dije se synimi i tij gjithmonë ka qenë të luajë në "Camp Nou". I pyetur pse ende është në Basel në moshën 22-vjeçare,

Zhegrova ka deklaruar: "Sepse dua të shkoj hap pas hapi". "Herët a vonë do të luaj për Barcelonën. Gjithmonë kam thënë se ky është synimi im dhe nuk do të ndalem derisa t'ia dal", ka shtuar Zhegrova, i cili ka shënuar katër gola dhe gjashtë asistime në 15 ndeshje në të gjitha garat deri tani.



Hamiltoni merr titullin 'kalorës' nga Princi Charles

LONDËR, 15 DHJETOR - Piloti i garave të Formulës 1, Lewis Hamilton, mori titullin "kalorës" vetëm disa ditë pas thyerjes së zembrës së tij në kampionatin e F1, ku nuk arriti ta shkruajë historinë me titullin e tetë. 36-vjeçari Hamilton u

nderua nga Princi Charles në një ceremoni në Kështjellën Windsor mëngjesin e së mërkurës. Ai shoqërohej në ceremoni nga nëna e tij Carmen Larbalestier, e cila, së bashku me babanë e tij, Anthony, kanë qenë

mbështetës entuziastë të karrierës së tij në F1. Hamiltoni, shtatë herë kampion bote në Formula 1, mori titullin 'kalorës' për shërbimet e tij në Formula. Ai bashkohet me Sir Jackie Stewart, Sir Stirling Moss dhe Sir Jack

Brabham si garuesi i katërt në F1 që shpallet kalorës. Ky titull vjen vetëm disa ditë pasi Hamiltoni humbi titullin e tij rekord të tetë, duke u mposhtur nga piloti holandez Max Verstappen, në garën e çmendur dhe të diskutueshme në Abu Dhabi.



Aguero i përloitur i thotë lamtumirë futbollit: Gjëja e parë është shëndeti

BARCELONË, 15 DHJETOR - Kun Aguero është ngjitur në skenë i emocionuar dhe shumë i trishtuar. Argentinasi nuk ka mbajtur lotët dhe i janë dashur disa minuta të merrte veten pasi nuk ishte në gjendje të fliste. "Kam ardhur këtu për të thënë se do të heq dorë përfundimisht nga futbollit. Ky është një vendim shumë i vështirë për mua dhe nuk e kam menduar kurrë se do të arrija në këtë pikë, ku gjithçka që kam dashur që kur kam qenë i vogël të më zhduket kështu në këtë mënyrë. Është një kohë shumë e vështirë, por gjithsesi jam shumë i lumtur. Gjëja e parë është shëndeti im. E dini pse e mora këtë vendim? Është për shkak të problemit që pata një muaj më parë. Isha në duart e mira të mjekëve, të cilët më thanë se ishte për të mirën. Vendimin e mora 10 ditë më parë. Bëra të pamundurën për të parë nëse kishte ndonjë shpresë, por nuk kishte shumë",



ka thënë Aguero. "Ëndrra ime ishte të luaja në Kategorinë e Parë dhe nuk e kisha menduar kurrë se do të shkoja në Evropë. Dua të falënderoj Independiente, Atletico Madrid, Manchester City dhe Barcelona. Të gjithë më kanë trajtuar shumë mirë. Dhe, qartë, për Kombëtaren e Argentinës, e cila është ajo që unë dua. Bëra gjithçka për të fituar.

Faleminderit kolegëve të mi që më ndihmuan me këtë! Nuk e di se çfarë do të më presë në jetën tjetër, por e di që kam shumë njerëz që më duan dhe që duan më të mirën për mua. Dua t'i falënderoj edhe gazetarët, ata që më trajtuan mirë dhe ata që më kritikuan. Faleminderit të gjithëve! Më kanë mbetur shumë gjëra të bukura", ka deklaruar Aguero.

Golden State nuk njeh pengesa, Phoenixi e Brooklynin buzëqeshin pas kohës shtesë

NJU-JORK, 15 DHJETOR - Golden State thëllon edhe më shumë dallimin me rivalët në NBA pas fitores ndaj New Yorkut me rezultatin 105-96. Suksesi i 23-të sezonal për Warriorsin (ka edhe 5 humbje), që udhëheq renditjen në Konferencën e Perëndimit. Curry me 22 pikë ishte shënuesi më i mirë për miqtë, ndërkohë që 34 pikë erdhën nga lojtarët e stolit. Replikon me fitore edhe Phoenixi, që mundi 11-107 pas kohës shtesë rivalët e Portlandit, në një ndeshje me



rivalitet. Ayton ishte lider në parket për Phoenixin, që realizoi 28 pikë e 13 rebounde, mbështetur edhe nga Pauli me 24 pikë. Pas kohës shtesë fiton edhe Brooklynin, që mundi me rezultat 131-129 Toronto, sfidë ku dallimin e bëri Kevin

Duranti, me një "triple double". Duranti realizoi 34 pikë, 13 rebounde e 11 asistime, ndërsa Millsi 30 pikë. Të gjithë titullarët e Netsit realizuan mbi 10 pikë, duke i bërë të pavlefshme 31 pikët e Van Vleet për kanadezët.

REZULTATET

| | |
|-------------------------|---------|
| Brooklyn - Toronto | 131-129 |
| New York - Golden State | 96-105 |
| Portland - Phoenix | 107-111 |

SHKURT

Barça ofron Dembelen për Aubameyangun

Sulmuesit Pierre-Emerick Aubameyang iu hoq shiriti i kapitenit të Arsenalit dhe ai nuk do të luajë të mërkurën kundër West Hamit pasi u kthye në klub me vonesë nga një shëtitje me anije. 32-vjeçari mund të rikthehet në skuadër për ndeshjen e së shtunës kundër Leeds Unitedit. E ardhmja e tij në Arsenal është e pasigurt dhe ai mund të shitet në janar. Barcelona ka treguar interesim për sulmuesin aktual të Arsenalit, madje mediet britanike raportojnë se Barça është e gatshme ta ofrojë Ousmane Dembelen në një marrëveshje të mundshme shkëmbimi.

Modriqi dhe Marcelo rezultojnë pozitivë me Covid-19

Luka Modriqi dhe Marcelo kanë dalë pozitivë me Covid-19 u bë me dije nëpërmjet një komunikate nga klubi madrilen. Marcelo kohën e fundit më shumë ka qëndruar në bankën rezervë, por mungesa e kroatit do të jetë e dukshme për klubin pas paraqitjeve mjaft të mira të tij.

Pochettino: Kemi cilësi për ta mposhtur Realin

Paris Saint-Germain do të përballet me Real Madridin në 1/8 e finales së Ligës së Kampionëve. Ndonëse kjo është një ndeshje më e vështirë për të dyja skuadrat sesa ishte caktuar fillimisht për të luajtur, trajneri i PSG-së, Mauricio Pochettino, është i bindur se skuadra e tij mund ta sigurojë kalimin, shkruan "Marca". "Do të jetë një ndeshje e vështirë sepse ata janë një ekip me një supertrajner dhe superlojtar", ka thënë argentinasi në një intervistë për mediet zyrtare të Klubit të PSG-së. "Ne do të përballemi me Real Madridin, i cili është një ekip i mësuar ta fitojë Ligën e Kampionëve, një ekip me histori dhe shumë përvojë. Është e qartë se ne kemi një ndeshje shumë të vështirë. Ne kemi mjaft cilësi për të fituar këtë ndeshje dhe për të kaluar në raundin tjetër. Ky është objektivi i Paris Saint-Germainit", ka deklaruar Pochettino.

Benzema: Duhet fituar të gjitha ndeshjet për ta merituar Ligën e Kampionëve

"Është si vera, bëhet më i mirë me kalimin e moshës", këto ishin fjalët e Carlo Ancelottit për sulmuesin Karim Benzema. Ndërsa Zinedine Zidane ka deklaruar: "Ai është futbollist total". Benzema është shpallur nga "AS" si sportisti i vitit 2021 në Spanjë. Gjatë marrjes së këtij çmimi bomberit francez foli edhe për shortin e 1/8 finale në Ligën e Kampionëve. "Mendoj se duhet t'i fitoni të gjitha ndeshjet për ta fituar Ligën e Kampionëve. Parisienët kanë një ekip të madh, por edhe ne. Do të shkojmë atje për të fituar. Kjo është ndeshja që të gjithë duan të luajnë. Janë ndeshje shumë të rëndësishme për ne dhe për tifozët. Ne duam ta fitojmë Ligën e Kampionëve", ka shtuar Benzema.

Kupa e Kombeve në Afrikë mund të anulohet, shkak Covidi

Covid-19 nuk di të ndalur dhe kohët e fundit është rritur shumë numri i të infektuarve në të gjithë botën. "Pushimi" që po i bën koronavirusi vendit është shumë i madh, i cili herë

pas here ka anuluar edhe ndeshje të rëndësishme siç ishte ajo në mes të Tottenhamit dhe Rennesit në Ligën e Konferencës apo dhe dy ndeshjeve të tjera në Premierë

Ligë. Por jo vetëm kaq, të tjera ndeshje të rëndësishme mund të anulohen. Sipas informacioneve nga RMC, Kupa e Kombeve të Afrikës mund të anulohet. CAF së

shpejti mund ta shpallë anulimin e edicionit 2022. Ishte planifikuar të luhet në Kamerun, por për shkak të numrit të madh të rasteve me Covid-19, ky kampionat mund

të mos zhvillohet fare. Edhe klubet evropiane kanë reaguar fuqishëm ndaj masave të dobëta në këtë kompeticion dhe se nuk janë të interesuar t'i lëshojnë futbollistët e tyre.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook


www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Abrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► N.T.P "TINA COM", me numër të biznesit: 70848082, shpall të pavlefshme Licencën për Transport Rrugor Ndërkombëtar të Mallrave e lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transporteve me numër: 032/027/2019. Prishtinë.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e

veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

